




Elite Travel Agency

EKSPLORO



BOTËN

UDHËTIM NË KAZAKISTAN
25 PRILL 2026



FLUTURIMET

Fluturimi Shqipëri – Kazakistan 25 Prill 2026 (Lufthansa Airlines)

Tiranë (TIA) – Frankfurt (FRA) : 06:00 – 08:20

Frankfurt (FRA) – Astana (NQZ) : 12:35 – 22:15

Fluturimi Kazakistan – Shqipëri 1 Maj 2026 (Lufthansa Airlines)

Almaty (ALA) – Frankfurt (FRA) : 01:05 – 08:40

Frankfurt (FRA) – Tiranë (TIA) : 11:15 – 13:25



ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI



Dita 1 : Nisja nga Tirana drejt Astanës

Udhëtimi ynë në Kazakistan nis duke u takuar me guidën rreth orës 04:00 – 04:30 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 06:40. Udhëtojmë drejt Frankfurtit, mbërrijmë në orën 09:05. Marrim fluturimin për në Astana në orën 12:30.

Sapo mbërrijmë në **Aeroportin Nursultan Nazarbayev (NQZ)** rreth orës 22:15, do të takohemi me guidën tonë lokale, i cili do të na shoqërojë gjatë të gjithë këtij udhëtimi. Nisemi për në Astana dhe bëjmë check-in në hotel.

Fjetja në **Kazzhol Astana Hotel 4***.

Dita 2 : Astana – Kryeqyteti Modern i Kazakistanit

Pas një mëngjesi të shijshëm në hotel, nisemi për të vizituar **Muzeun Kombëtar të Republikës së Kazakistanit**. I vendosur në zemër të Astanës, Muzeu Kombëtar i Republikës së Kazakistanit është një pikë referimi kulturore që duhet vizituar patjetër, e cila ofron një udhëtim magjepsës përmes historisë dhe trashëgimisë së pasur të kombit. I themeluar në një ndërtesë moderne mbresëlënëse prej xhami blu dhe mermeri të bardhë, muzeu shfaq një koleksion mbresëlënës të shpërndarë në salla të shumta, nga objektet e lashta deri te ekspozitat e detajuara mbi etnografinë, artin dhe historinë e Kazakistanit të pavarur, çdo seksion sjell në jetë të kaluarën e gjallë të vendit.

Mbarojmë vizitën në muze dhe konsumojmë drekën në një restorant të qytetit.

Shijojmë drekën dhe drejtohemi për në **Xhaminë e Madhe të Astanës**, një ndër xhamitë më të mëdha dhe më të bukura në Azinë Qendrore. Kjo xhami, e përfunduar së fundmi në vitin 2022, është një simbol i arkitekturës islame dhe një shembull i shkëlqyer i ndërtimit modern të qytetit. Pamjet që kjo xhami ofron nga jashtë dhe brenda janë të mahnitshme dhe teper të vecanta.

Udhëtim në Kazakistan vazhdon me një eksperiencë të paharrueshme në **Khan Shatyr Mall**, një qendër tregtare madhështore e ndërtuar në një tendë transparente, ku mund të bëjmë shopping dhe të shijojmë gastronomi ndërkombëtare dhe lokale.

Konsumojmë darkën në një restorant. Fjetja në **Kazzhol Astana Hotel 4***.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka



ITINERARI



Dita 3 : Astana – Tur i Qytetit dhe Pamjeve të Mrekullueshme

Shijojmë mëngjesin në hotel dhe nisim ditën tonë të tretë në Astana, ku do të zbulojmë disa nga monumentet dhe atraksionet më të njohura të qytetit.

Fillojmë vizitën tonë me **Sheshin e Pavarësisë**, një nga vendet më të rëndësishme dhe më të bukura të qytetit, ku mund të admirojmë shatërvanët dhe monumentin **Kazakh Eli**. Ai përfaqëson krenarinë dhe lirinë e fituar pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1991. Ky monument i lartë është një pasqyrë e forcës dhe unitetit të popullit kazak, i cili ka kaluar shumë sfida për të arritur aty ku është sot.

Vizitojmë **Xhaminë Khazret Sultan**, një nga xhamitë më të mëdha dhe më të bukura të Azisë Qendrore. Kjo xhami është një shembull i shkëlqyer i arkitekturës islame. Shkëlqimi i kupolës së artë dhe madhështia e minareve të saj do të na lënë pa fjalë.

Vazhdojmë turin për të vizituar **Pallatin e Paqes dhe Pajtimit (Palace of Peace and Reconciliation)**, një nga ndërtesat më të veçanta dhe më të njohura të Astanës. Ky pallat është një simbol i unitetit ndërmjet grupeve fetare dhe etnike të Kazakistanit. Forma e tij piramidale i jep një ndjenjë të fuqishme të bashkimit dhe paqes. Pallati është gjithashtu një vend ku organizohen ngjarje ndërkombëtare, dhe ka si qëllim të promovojë paqen dhe bashkëpunimin global.

Pas vizitës në Pallatin e Paqes, do të vazhdojmë me një vizitë drejt **Monumentit Astana-Bayterek**, një nga simbolet më të njohura të qytetit. Ky monument është një vepër e jashtëzakonshme arkitektonike dhe është i lidhur ngushtë me mitologjinë kazake. Ai përfaqëson ëndrrat dhe aspiratat e popullit kazak për të arritur lartësi të reja në zhvillim dhe prosperitet. Monumenti është 105 metra i lartë dhe ofron pamje panoramike të mrekullueshme të qytetit dhe përreth.

Vizitojmë **Green Water Boulevard**, një nga bulevardet më të bukura dhe më të gjelbra të qytetit. Ky bulevard është një vend perfekt për tu relaksuar sadopak mes ajrit të pastër. Do të mund të shijoni bukurinë natyrore të këtij vendi dhe të bëni një shëtitje të qetë mes pemëve dhe luleve, përpara se të vazhdojmë me ndalesat dhe vizitat e tjera. Për të mbyllur këtë paradite, do të vizitojmë **Round Square**, një nga sheshet më të njohura të qytetit.

Pas vizitës në shesh, do të konsumojmë drekën në një restorant të qytetit.

Dreka e shijshme na pret dhe me pas do të kemi mundësi të vizitojmë Xhaminë Nur-Sultan, një nga xhamitë më të mëdha dhe më të bukura në Kazakistan, e njohur për kupolën e saj të artë dhe minaret e larta. E ndërtuar si pjesë e zhvillimit të qytetit të ri, ajo mbështetet në teknologjinë moderne për të promovuar edukimin dhe aktivitetet fetare.

Konsumojmë darkën në një restorant. Fjetja në **Kazzhol Astana Hotel 4***.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka



ITINERARI



Dita 4 : Astana – Shkëlqimi i Almaty

Nisim ditën me fluturimin për në **Almaty**, qytetin e njohur për bukurinë e tij natyrore dhe historinë e pasur. Almaty është një qytet i ngrohtë dhe mikpritës, i rrethuar nga malet e mrekullueshme të Tien Shan, që i japin një pamje spektakolare nga çdo këndvështrim.

Pas mbërritjes dhe akomodimit, do të konsumojmë drekën në një nga restorantet e qytetit.

Drejtohemi për në **Kok Tobe**, një nga pikat më të larta të qytetit, ku mund të shijojmë perëndimin dhe pamjet mahnitëse të Almaty dhe rrethinave të tij. Do të ndërmarrim një udhëtim fantastik me teleferik për në majë, duke na ofruar mundësinë për të parë qytetin nga lart dhe për të realizuar disa foto të paharrueshme. Ndërsa dielli perëndon në horizont, do të shikojmë qytetin të kthehet në një kaleidoskop ngjyrash, nën sfondin e maleve madhështore. Këtu mund të konsumojmë dhe darkën për këdo që dëshiron.

Konsumojmë darkën në një restorant. Fjetja në **Resident Abay 4***.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

Dita 5 : Ekskursion në Liqenet Kolsai dhe Kanionin Charyn

Dita e pestë do të na çojë drejt dy prej peizazheve më të bukura natyrore të Kazakistanit – **Liqenet Kolsai** dhe **Kanioni Charyn**.

Ky udhëtim është një mundësi për të përjetuar bukurinë mahnitëse të natyrës së Kazakistanit, për të shijuar ajrin e pastër të malit dhe pamjet spektakolare. **Liqenet Kolsai**, të quajtur ndryshe “Liqenet e Kaspisë”, janë një seri liqenesh alpine që shtrihen në malet e **Tien Shan**. Liqeni i parë është i thellë dhe kristal, ndërsa liqenet më të vegjël janë të mbushura me ujë të freskët dhe të pastër, të ndriçuar nga dielli. Shëtitjet nëpër brigjet e liqeneve do të na ndihmojnë të shijojmë paqen e natyrës dhe veçantinë që ky vend ka.

Pasi të kalojmë disa orë të mrekullueshme pranë liqeneve, do t'i drejtohem Kanionit Charyn, një nga bukuritë më të veçanta natyrore të Kazakistanit. Ky kanion është i njohur për ngjyrat e tij të mrekullueshme dhe formacionet e shkëmbinjve, që ngjajnë me ato të **Grand Canyon** në SHBA. Ky vend është një oazë për adhuruesit e natyrës dhe të fotografisë, dhe do të na ofrojë mundësinë për të eksploruar pamje të jashtëzakonshme të këtij peizazhi të natyrës së egër e të bukur. Gjatë shëtitjes në kanion, do të kemi gjithashtu mundësi të shohim shkëmbinjtë që formojnë “kullat” natyrore.

Pas ekskursioneve dhe eksplorimeve, do të ndalojmë për një drekë të shijshme pranë liqenit në një nga restorantet e zones.

Pas drekës, do të kthehemi në **Almaty** për të kaluar natën dhe për të shijuar një darkë të shijshme në një restorant të zgjedhur, duke përfunduar kështu një ditë të paharrueshme, të mbushur me peizazhe magjepsëse dhe momente të çmuara. Gjatë rrugës do të kemi mundësi të shikojmë grimca të jetës Kazake rurale si dhe natyrën e virgjër mes maleve.

Konsumojmë darkën në një restorant. Fjetja në **Resident Abay 4***.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka



ITINERARI



Dita 6 : Shymbulak Ski Resort dhe Almaty

Ditën e fundit të udhëtimit tonë, do të kemi mundësinë të shijojmë disa nga atraksionet më të bukura të Almaty dhe natyrën e mrekullueshme të Kazakistanit. Pas një mëngjesi të shijshëm në hotel, do të nisemi për në **Shymbulak Ski Resort**, një nga destinacionet më të njohura për ski dhe aktivitete malore në Kazakistan.

Ky resort është i vendosur në malet e Tien Shan dhe ofron mundësi për të shijuar ski gjatë dimrit dhe hiking gjatë verës. Ndërsa shkëlqen për bukurinë e tij natyrore, Shymbulak është gjithashtu një vend ku mund të shijoni pamje spektakolare nga maja e malit, ndërsa jemi të rrethuar nga ajri i pastër dhe natyra tërheqëse.

Për ata që preferojnë ngjitje në mal, resorti ofron mundësi të mrekullueshme për të eksploruar shtigjet e malit dhe për të shijuar pamje fantastike. Gjatë vizitës, do të ngjitemi me **Gondolën L3**, një mundësi për të parë Almaty-n dhe malet përreth nga një këndvështrim i jashtëzakonshëm. Udhëtimi me teleferik është një përvojë e mrekullueshme, ndërkohë mund të shkrepim dhe disa foto nga lartësia.

Një tur në **Almaty** na pret, ku do të zbulojmë bukuritë e qytetit. Fillojmë me një vizitë në **Republic Square**, ku mund të shohim monumentin e **Pavarësisë** dhe **Palatin e Republikës**, të dyja simbole të rëndësishme të pavarësisë dhe identitetit kulturor të Kazakistanit. Kjo pjesë e qytetit është një shembull i përkryer i zhvillimit urban dhe historisë së pasur të Almaty.

Pas kësaj, do të drejtohem për një vizitë në **Panfilov Park**, një vend i qetë dhe historik që nderon heronjtë e Luftës Patriotike të Madhe. Ky park është i njohur për atmosferën e tij të qetë dhe për **Katedralen Zenkov**, një nga ndërtesat më të mëdha prej druri në botë. Katedralja është një shembull i mrekullueshëm i arkitekturës ortodokse dhe ngjyrave të ndezura, dhe është një nga atraksionet më të vizituara të Almaty.

Ky udhëtim, plot kulturë, histori dhe bukuri natyrore, do të mbetet në kujtesën tonë për një kohë të gjatë. Kazakistani na ka ofruar mundësinë për të zbuluar një vend të jashtëzakonshëm, dhe këtë ditë të fundit, do ta mbyllim me një **darkë të shijshme në një restorant të përzgjedhur**. Pas kësaj, do të përgatitemi për transferimin në aeroport për fluturimin e kthimit.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka



DETAJET E SHËRBIMIT

Kategoria e Hoteleve: 4* & 5*

Numri i ditëve: 6

Numri i netëve: 5

Qytetet që vizitohen: 2: Astana (Nursultan), Almaty

Monumentet që vizitohen: 19: Muzeu Kombëtar i Republikës së Kazakistanit, Xhamia e Madhe e Astanës, Qendra Tregtare Khan Shatyr, Sheshi i Pavarësisë, Stela Kazake Eli, Pallati i Paqes dhe Pajtimit, Monumenti Astana-Bayterek, Bulevardi i Ujit të Gjelbër, Sheshi i Rrumbullakët, Xhamia Nur-Sultan, Kodra Kok Tobe dhe Teleferiku, Liqenet Kolsai, Kanioni Charyn, Mali Shymbulak dhe Resorti i Skive (Gondola e Nivelit 3), Sheshi i Republikës dhe Monumenti i Pavarësisë, Pallati i Republikës, Parku i Presidentit të Parë, Parku Panfilov dhe Katedralja Zenkov

Aktivitetet: 7: Ture me guidë në qytet në Astana dhe Almaty, Vizita në muze dhe xhami, Blerje në Qendrën Tregtare Khan Shatyr, Udhëtim piktoresk me teleferik për në Kok Tobe, Ekskursion njëditor në natyrë në Liqenet Kolsai dhe Kanionin Charyn, Ekskursion malor në Shymbulak me përvojë në gondola, Tur kulturor në këmbë duke përfshirë Parkun Panfilov dhe Katedralen Zenkov.

Numri total i vakteve të përfshira: 10

Mëngjese: 5

Darka: 5

HB në ditët: 2, 3, 4, 5, 6

KM: 835 km

Kohë totale transporti në rrugë tokësore: 18 orë

Distanca mesatare e përshkruar: 139 KM/Ditë

Koha mesatare e transportit: 3 orë/ditë

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ASTANA – KAZZHOL ASTANA 4*

(8.2 RATING NE BOOKING DHE 4.5 NE GOOGLE)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ALMATY – RESIDENT ABAY 4*

(9.2 RATING NE BOOKING DHE 4.4 NE GOOGLE)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



PËRSE TË UDHËTONI ME NE?

- Paketa të kuruara me kujdes për çdo moshë dhe interes
- Eksperiencia autentike kulturore në çdo destinacion. Cdo dite ka nje moment kulminant, qe eshte nje eksperience dhe nje aktivitet, Unesco Sites.
- Grupi optimal: 15–35 persona për një eksperiencë më personale
- Nuk ka kosto të fshehura – transparencë totale në çmim
- Fluturime të organizuara në grup me linja zyrtare per udhetime nderkontinentale ku bagazhet behen me checkin te plote pa dale nga aeroporti (jo low cost të papërshtatshme) – Bagazhet 23 KG gjithmone te perfshira
- Guida profesioniste dhe të përkushtuara, që flasin gjuhën tuaj
- 25 vite përvojë në organizimin e udhëtimeve cilësore
- Kujtime që zgjasin një jetë – jo thjesht një udhëtim
- Mbështetje 24/7 para, gjatë dhe pas udhëtimit
- Programe të pasura në përmbajtje kulturore dhe edukative
- Akomodim në hotele të përzgjedhura me standartin: 4 Superior / 5
- Vizat gjithmone te perfshira ne cmim

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



INFORMACIONE TË RËNDËSISSHME

Kushtet e Rezervimit dhe Pagesës

6.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti pranon të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për rezervimin e Shërbimit. Pagesa për Shërbimet do të bëhet nga Klienti në mënyrën e mëposhtme:

1. Depozita

- Konfirmimi i rezervimit. Pas konfirmimit të rezervimit, Klienti do të depozitojë shumën prej 25 % të kostos totale të Shërbimit të paketës EB. Kjo depozitë siguron rezervimin e Klientit dhe i lejon Agjencisë të fillojë të bëjë rezervimet e nevojshme.
- Depozitë e Parimbursueshme: 10% e shumës totale të udhëtimit nuk do të jetë e rimbursueshme në asnjë rast nga Operatori i shërbimeve përveç në rrethanat e përcaktuara në Marrëveshje, siç është anulimi nga Operatori i shërbimeve ose ngjarjet e forcës madhore. Kjo politikë është në fuqi për të mbuluar çdo kosto të shkaktuar nga Operatori i shërbimeve në rast të një anulimi.
- Koha e Depozitës: Depozita duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas konfirmimit të rezervimit, kur rezervimi bëhet të paktën 3 muaj përpara. Kjo siguron që Operatori i shërbimeve të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për udhëtimin e Klientit.

2. Pagesa e pjesës së mbetur të kostos totale

- Pagesa finale: Bilanci i pagesës duhet të paguhet nga Klienti jo më vonë se 45 ditë para datës së fillimit të shërbimit. Kjo i lejon Agjencisë të konfirmojë të gjitha rezervimet dhe të finalizojë të gjitha përgatitjet.
- Pagesa të Vonuara: Moskryerja e pagesave në kohë mund të rezultojë në moskonfirmimin e rezervimeve pa njoftim të mëtejshëm. Kjo politikë është në fuqi për të siguruar që Operatori i shërbimeve të mund të përmbushë angazhimet e saj ndaj ofruesve të shërbimeve.
- Tarifa për Pagesë të Vonuar: Në rast të pagesës së vonuar, Operatori i shërbimeve mund të vendosë një tarifë shtesë pagese prej 10% të shumës së papaguar. Kjo tarifë kompenson Agjencinë për punën shtesë administrative të përfshirë në trajtimin e pagesave të vonuara.

3. Për rezervimet e kryera/konfirmuara jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit:

Për të gjitha rezervimet e kryera brenda këtij afati (jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit deri në ditën e nisjes), rezervimi quhet i konfirmuar në momentin që është kryer 100% e pagesës.

Anulimi dhe Rimbursimet

7.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti mund të anulojë Shërbimet të paketës EB në varësi të kushteve të mëposhtme:

1. Njoftimi dhe Tarifat e Anulimit

1.Njoftim më shumë se 60 ditë: Anulimet e bëra më shumë se 60 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 10% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që mbulon kostot administrative që lidhen me anulimin e Shërbimeve të paketës EB.

2.Njoftim më pak se 59 ditë: Anulimet e bëra më pak se 59 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 40% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që pasqyron vështirësinë e plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

3.Njoftim më pak se 30 ditë: Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai më pak se 30 ditë përpara udhëtimit, klientit nuk i kryhet asnjë rimbursim nga ana e kompanisë, tarifë që pasqyron vështirësinë në rritje të plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

4.Mosparaqitje: Në rast mosparaqitjeje, nuk do të jepet rimbursim. Kjo politikë është në fuqi sepse Operatori i shërbimeve do të kishte bërë të gjitha rregullimet e nevojshme dhe nuk do të ishte në gjendje të rikuperonte këto kosto.

5.Anulimi i paketave të shërbimit për kategorinë “Eksploro Botën” mund të realizohet vetëm ndërmjet një kërkesë të paraqitur me shkrim, përmes emailit zyrtar, aplikacionit WhatsApp, ose me paraqitje fizike në zyrat e Elite Travel LCC Tiranë. Çdo kërkesë verbale, telefonike apo e paformalizuar me një dokument të shkruar nuk do të konsiderohet e vlefshme për procedurat e anulimit.

Me kryerjen e rezervimit dhe dërgimin e konfirmimit nga ana e Klientit, pavarësisht formës së tij (me shkrim, elektronik, përmes emailit, WhatsApp-it, pagesës së depozitës apo pagesës së plotë), kjo kontratë konsiderohet e pranuar plotësisht dhe pa asnjë kusht nga Klienti.

Ju lutemi për informacion më të detajuar vizitoni linkun për Kontratën me Klientin. [Klikoni këtu](#)

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



Elite Travel Agency

Everlasting Experiences

WWW.ELITETRAVEL.AL